



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2068, datë 14. 06. 2012

Për

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1911, datë 30.4.2012, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Albtelcom sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës _____.____.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1911, datë 30.4.2012, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Albtelcom sh.a.”, të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);

- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- AKEP me anë të Vendimit 1911, datë 30.4.2012, “*Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelcom sh.a.*”;
- Shkresën nr. 17Prot., datë 11.5.2012 (nr. 685/4Prot. i AKEP, datë 11.5.2012) “*Dërgimi i pretendimeve mbi mosmarrëveshjen e Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. me Albtelcom sh.a.*”;
- Shkresën me nr. 2538Prot., datë 21.5.2012, (nr. 685/5Prot., datë 21.5.2012) “*Pretendimet me shkrim të shoqërisë Albtelcom sh.a. mbi procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së akses/interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë (OSHKP) me Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k.*”, si edhe,
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit 1911, datë 30.4.2012, për “*Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k. dhe Albtelcom sh.a.*”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

- “Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.”;
- Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Altelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;
- Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;

II. Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. me shkresën nr. 17, datë 11.5.2012, “*Dërgimi i pretendimeve mbi mosmarrëveshjen Alban Tirana-Altelecom sh.a.*”, sqaron si poshtë:

- Në lidhje me vlerën e tarifës së origjinimit të thirrjeve në rrjetin e Altelecom sh.a., e cila sipas VKD nr. 1348, datë 26.7.2010, është 3.5 lekë/min dhe 0.83 lekë/thirrje, pavarësisht që Altelecom është OFNT dhe një ndër detyrimet rregullatore është orientimi i tarifave të shërbimeve të shumicës drejt kostos së ofrimit të shërbimit eficient.
- Mostrajtimi me të njëjtën llogjikë arsyetimi dhe praktike normale për segmentimin e shërbimit të origjinimit të thirrjeve si për shërbimin e terminimit të thirrjeve, pra segment lokal, njëfish të dhe të dyfish të, duke qenë se bëhet fjalë për numra gjeografikë.

Alban Tirana, duke kërkuar vlerësimin profesional të AKEP, me qëllim që ofruesi i shërbimit të thirrjes me kartë të parapaguar Alban Tiran të vazhdojë të ekzistojë, sugjeron të merren në konsideratë argumentet e mëposhtme:

1. Ndërhyrjen e AKEP për tarifën e shërbimit për origjinimin e thirrjeve në rrjetin e Altelecom duke qenë se tarifa aktuale sipas VKD nr. 1348, nuk ka asnjë element justifikues për të qenë e tillë;
2. Përse nuk implementohet rezultati që ka sjellë studimi sipas modelit të BULRAIC për llogaritjen e kostove të shërbimeve publike të telefonisë fikse të OFNT Altelecom, sipas të cilit është deklaruar kosto për segmentin dyfish prej 1.86 lekë. Për këtë kërkojmë të sqarohemi si u arrit të miratohet një cmim pre 3.5 lekë, që është afërsisht 200% i vlerës së koston, kur sipas ligjit një OFNT nuk i lejohen këto marzhe fitimi? Alban Tirana shpjegon se kjo është zanafilla e gjithë abuzimit të Altelecom me cmimin e aksesit, kur në të vërtetë kosto e tij ka qenë shumë më e vogël, aq me shumë me futjen e teknologjisë së re, ku sipas çdo reference ndërkombëtare që mund të gjendet këto kosto duhet të jenë shumë të ulta.
3. Në se nuk implementohet BULRAIC, atëherë sipas të gjitha praktikave të ndjekura nga rregullatorë të tjerë, por edhe nga AKEP, para VKD nr. 1348, të implementohen rezultatet e Benchmark për shërbimin e origjinimit të thirrjeve.
4. Shpjegimin dhe argumentimin nga Altelecom sh.a. se si është e mundur që kjo kompani për shërbime të njëjta bën oferta të cilat shkojnë më pak se 1 lek/min për segment dyfish.

5. Ndërhyrjen e AKEP në zgjidhjen e problemit të tarifimit të tarifës për segment dyfish kur në të vërtetë më shumë se 60% e trafikut që origjinohet është në Tiranë ku Alban Tirana ka interkoneksionin dhe është në kushtet e interkoneksionit njëfish dhe pjesa tjetër është në rrethe.
6. Alban Tirana, kërkon ndërhyrjen e AKEP sa i takon tarifës së E1, e cila në të gjithë operatorët e tjerë është zero sepse prej këtij interkoneksionit përfitimi është i të dy kompanive dhe tarifa e mirëmbajtjes është abuzive.

Alban Tirana, mbështetur në argumentat e mësipërme, si dhe eksperiencën e praktikës së ndjekur nga AKEP para hyrjes në fuqi të VKD 1348, datë 26.7.2010, kërkon:

Në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes ndërmjet Alban Tirana dhe Albtelecom të konsiderohen si pika të mosmarrëveshjes (1) vlera e tarifës së origjimit dhe (2) segmentimi i shërbimit të origjinimit.

Alban Tirana gjendet në një moment diskriminimi të rëndë nga ana e Albtelecom, prandaj kërkon ndërhyrjen e AKEP, për të shpëtuar nga falimentimi një ofrues shërbimi të KPP, aktiv në treg për një periudhë të gjatë kohe dhe me investim të konsiderueshem në këtë drejtim.

- III. Albtelecom sh.a. me shkresën nr. 2538Prot., datë 21.5.2012, ka sjellë pretendimet mbi *“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”*. bëjmë me dije se këto pretendime janë sjellë jashtë afatit të përcaktuar sipas pikës 4, të vendimit nr. 1911.

Albtelecom sh.a., në këto pretendime sqaron se:

Me shkresën nr. 4948Prot., datë 1.11.2011, ka njoftuar Alban Tirana për plotësim dokumentacioni për nënshkrimin e MI së re për akses/interkoneksion për OSHKP mes Alban Tirana dhe Albtelecom, bazuar në RIO-n e re.

Në takimin e dt. 9.11.2011, të zhvilluar mes palëve, nuk është arritur lidhja e MI, sepse Alban Tirana nuk ka rënë dakord me çmimin e origjinimit të Albtelecom prej 3.5 lekë/min, dhe 0.83 lekë/thirrje.

Alban Tirana, pretendon se për klientët fundorë Albtelecom e shet këtë shërbim me çmim më të ulët, duke sjellë si shembull ofertën “Fol Fix 1500”. Në lidhje me këto pretendime Albtelecom sqaron se, tarifa për shërbimin e origjinimit të thirrjeve prej 3.5 lekë/min, dhe 0.83 lekë/thirrje, është tarifë nën rregullim, e miratuar nga AKEP me VKD nr. 1348, datë 26.7.2012, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”*. Kjo tarifë është aplikuar nga Albtelecom për të gjithë operatorët e OSHKP prej datës 1.9.2010.

Sa i takon llogaritjes së tarifës për minutë të ofertës “Fol Fix 1500” shitet në paketë me çmim 1500 lekë.

Albtelecom ka të drejtë të bëjë oferta speciale për pajtimtarët e tij, oferta të cilat në zbatim të ligjit dhe kuadrit rregullator janë publikuar e njoftuar rregullisht në AKEP.

Oferta “Fol Fix 1500” nuk krahasohet me OSHKP, sepse ky i fundit është dizenuar për për thirrje në distancë të gjatë.

Sa i takon rritjes së tarifës për thirrjet hyrëse ndërkombëtare nga Albtelecom, prej dt. 1.7.2011, Alban Tirana ka ulur sasine e trafikut të terminuar në Albtelecom, sqarojmë se ky ndryshim është bërë në përputhje me VKD nr. 1348.

Nga të dhënat e trafikut, shihet se Alban Tirana rrugëzon kryesisht për thirrje ndërkombëtare e shumica e këtij trafiku nuk rrugëzohet nga Albtelecom. Megjithëse tarifatat për thirrjet ndërkombëtare hyrëse nuk janë në rregullim, Alban Tirana ka gjetur mënyra të tjera për të rrugëzuar trafikun ndërkombëtar, duke mos e dëmtuar konkurrencën por duke e nxitur atë.

Në se shohim pozicionin në treg të kartës Alban Tirana, në krahasim me kartën Alblue card të Albtelecom, shohim se Alban Tirana zotëron 58.7% të tregut ndërsa Alblue vetem 6.1%, që tregon se tregu është mjaft konkurues.

Albtelecom i ka ofruar shërbimin e akses/interkoneksionit Alban Tirana, pavarësisht se mes palëve nuk është arritur të lidhet MI e re dhe në mungesë të një garacie bankare të Alban Tirana.

Pretendimet e Alban Tirana për lidhje marrëveshje akses/interkoneksioni me tarifë origjinimi të ndryshme nga tarifa që aplikohet për cdo operator tjetër që përfiton këtë shërbim nga Albtelecom, janë në kundërshtim me detyrimin e mosdiskriminimit.

Për sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 9918, ligjit nr. 8485, KPrA, Rregullores së akses interkoneksionit, Albtelecom kërkon: Rrëzimin e pretendimeve të Alban Tirana si të pabazuara me kuadrin rregullator në fuqi, si edhe mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1911, datë 30.4.2012.

IV. AKEP, sa më sipër u parashtrua, për çështjet objekt të kësaj mosmarrëveshje pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a., arsyeton si më poshtë:

- Për sa i përket segmentimit të shërbimit të origjinimit dhe terminimit për OSHKP, AKEP vlerëson se:
 1. Në lidhje me pretendimin e Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k. për tarifën e shërbimit të origjinimit në rrjetin e Albtelecom sh.a., sqaron se, tarifa për shërbimin e origjinimit të thirrjeve prej 3.5 lekë/min, dhe 0.83 lekë/thirrje, është tarifë nën rregullim, e miratuar nga AKEP me VKD nr. 1348, datë 26.7.2010, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”*. Kjo tarifë është aplikuar nga Albtelecom e njëjtë për të gjithë operatorët e OSHKP prej datës 1.9.2010. Pra në kontekstin e diskriminimit midis operatorëve OSHKP Albtelecom nuk ka diskriminuar Alban Tirana Nascendo Al në raport me operatorët e tjerë. Arsyet pse janë vendosur tarifatat në nivelin e përcaktuar në VKD nr.1348, datë 26.07.2010, janë dhënë në dokumentin e Analizës së tregut të telefonisë fikse të miratuar me këtë vendim.
 2. Ofrimi nga Albtelecom i paketave tarifore me pagesë fikse më të lartë se pajtimi mujor duke përfshirë minuta falas kombëtare dhe ndërkombëtare në paketë si FolFiks, duket se është përshtatje e Albtelecom ndaj kushteve të tregut dhe konkurrencës për thirrje telefonike edhe nga rrjetet celulare (rritje shumë e madhe e thirrjeve telefonike nga rrjete celulare) dhe jo tentativë për të nxjerrë nga tregu OSHKP. Kjo vihet re edhe në pjesët e tregut të kartave me

- parapagim të Albtelecom që zotëron vetëm 6% kundrejt rreth 60% të Alban Tirana Nascendo Al.
3. Njëkohësisht sic ka sqaruar edhe më parë në takime me operatorët, AKEP vlerëson se OSHKP kanë pasur dhe kanë mundësitë e ofrimit të shërbimeve të tyre edhe për abonentët e rrjeteve celulare AMC dhe Vodafone, pas vendimeve të AKEP më 31.03.2010, ku ndaj këtyre dy operatorëve celularë janë vendosur detyrime specifike për ofrimin e origjinimit të thirrjeve për OSHKP.
 4. Shërbimet e ofruara nga OSHKP kanë interes direkt publik për pajtimtarët e Albtelecom pasi paraqesin një alternativë për kryerjen e thirrjeve telefonike dhe për kontroll të shpenzimeve telefonike. Këto shërbime rrisin konkurrencën në treg për thirrje telefonike dhe këta operatorë konkurrojnë direkt me Albtelecom: me kartat me parapagim të Albtelecom dhe me thirrjet e kryera normalisht.
 5. Marrëdhëniet e krijuara midis Albtelecom dhe OSHKP-ve në mënyrën e lidhjes së tyre me E1 dhe Pikë Interkoneksioni janë të ngjashme me interkonektimin e Albtelecom me operatorë të rrjeteve publike në formën e interkoneksionit të bashkvendosur në ambientet e Albtelecom.
 6. Nëpërmjet Vendimeve nr. 1599 dhe 1600 datë 22.04.2011, AKEP imponoi dhënien e aksesit për operatorët celularë AMC dhe Vodafone Albania për terminim në nivel njëfish në rrjetin Albtelecom, duke u bazuar në parimet e përfitimit të segmenteve të terminimit nëse operatori përfitues sjell trafikun në pikën përkatëse të interkoneksionit sipas përcaktimeve të RIO;
 7. Për sa më sipër, AKEP me qëllim rritjen e mëtejshme të konkurrencës për thirrje telefonike dhe alternativave të konsumatorëve për të kryer thirrje telefonike gjykon se origjinimi dhe terminimi i thirrjeve edhe për OSHKP duhet të fillojë nga data 1.07.2012 të tarifohet sipas segmenteve përkatës në varësi të pikës së interkoneksionit ku lidhet OSHKP me Albtelecom, dhe Albtelecom nuk duhet të mohojë aksesin në pika rajonale apo lokale interkoneksioni për OSHKP
- Për sa i takon tarifës së E1, AKEP ka shqyrtuar këtë ankesë për zgjidhjen e mosmarrveshjes Abissnet-Albtelecom për shërbimin me kartë të parapaguar, dhe me vendimin e marrë për këtë mosmarrveshje ka vendosur që AKEP të mos ndërhyjë në aplikimin ose jo të tarifës apo në nivelin e saj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me Vendimin nr. 1911, datë 30.4.2012, për *“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.”*,
2. Altelecom duke filluar nga 1.07.2012 të tarifoje për origjinimin dhe terminimi e thirrjeve për OSHKP sipas segmenteve përkatës në varësi të pikës së interkoneksionit ku lidhet OSHKP me Altelecom, dhe Altelecom nuk duhet të mohojë aksesin në pika rajonale apo lokale interkoneksioni për OSHKP.
3. Niveli i tarifave të origjinimit sipas segmenteve të jetë i njëjtë me nivelin e tarifave të terminimit sipas segmenteve përkatës të përcaktuar në VKD nr.1348, datë 26.07.2010.
4. Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Altelecom sh.a të lidhin marrëveshje për shërbimet me kartë të parapaguar duke zbatuar pikat 2 dhe 3 më sipër.
5. Altelecom sh.a të amendojë marrëveshjet me të gjithë operatorët OSHKP sipas pikave 2 dhe 3 më sipër.
6. Të njoftohen palët e interesuara Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Altelecom sh.a., për mbylljen e procedimit administrativ;
7. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE